

Vendim nr. 16 datë 22.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 22.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 33 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SHYQYRI TOLA, përfaqësuar nga avokate Erida Skëndaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 56, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në pjesën që parashikon moslejimin e rekursit për mosmarrëveshje që rrjedhin nga pagesa e aftësisë së kufizuar me vlerë më të vogël që dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

Shfuqizimi i vendimit nr. 19433 Regj.Themeltar (nr. 1261), datë 04.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën që i përket kërkesit.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 19433 Regj.Themeltar (nr. 1261), datë 04.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën që i përket kërkesit, deri sa të hyjë në fuqi vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 42, 52, 59, shkronja “e”, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese

të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorene e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (*ligji nr. 8089/1996*), u ka njohur personave të verbër një status të veçantë dhe përfitime të posaçme. Sipas nenit 5 të ligjit, pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitohen nga shteti, të verbërit marrin një shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie.

2. Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” (*VKM nr. 277/1997*), ka vendosur që pagesa për shkak të verbërisë të jetë sa 70% e pagës minimale. Në pikën 4 të VKM-së nr. 277/1997 parashikohej se masa e përfitimit për shkak të verbërisë indeksohej me rritjen e pagës minimale dhe në pikën 5 të këtij vendimi, mes të tjerave, parashikohej se të gjithë personat e verbër që kanë humbur vendin e punës për arsye të ndryshme pas 1 janarit të vitit 1991, përfitojnë 150% të vlerës së përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi deri në sistemimin e tyre në punë.

3. VKM-ja nr. 277/1997 është ndryshuar me VKM-në nr. 301, datë 27.06.2002, e cila ka përcaktuar si masë të pagesës 6 000 (gjashhtë mijë) lekë në muaj, e cila indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

4. Kërkuesi ka përfituar statusin e të verbërit dhe është trajtuar me pagesë invaliditeti PAK për periudhën 01.01.2000-01.02.2021. Për shkak të sëmundjes ka humbur vendin e punës, prandaj i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me kërkesë për pagesën shtesë në masën 150%, bazuar në VKM-në nr. 277/1997. Ministria i ka kthyer përgjigje se kjo pagesë përfitohej për të verbërit të cilët janë shkëputur nga puna pas datës 1 janar 1991 për arsye të ndryshme për shkak të verbërisë deri në sistemimin e tyre në punë.

5. Paga minimale në vend ka pësuar rritje dhe në këto rrethana kërkuesi Shyqyri Tola së bashku me tre persona të tjerë me të njëjtin status kanë pretenduar se rritja e pagës minimale duhet të sillte automatikisht edhe rritjen e masës së pagesës së verbërisë, për këtë arsye i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke paditur ministrinë, Bashkinë

Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme e atë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror me padi me objekt: (i) detyrimin e palëve të paditura për të paguar solidarisht detyrimet e prapambetura të pagesës së verbërisë për shkak të zbatimit gabim të indeksimit të përcaktuar në VKM-në nr. 277/1997 për periudhën nga data 01.08.2005 deri në datën 17.08.2010, si dhe pagesën e kamatëvonesës ligjore në momentin e ekzekutimit të këtyre detyrimeve; (ii) detyrimin e palëve të paditura të paguajnë solidarisht detyrimet e prapambetura të shtesës prej 50% të pagesës së verbërisë për shkak të humbjes së vendit të punës, sipas përcaktimeve të pikës 5 të VKM-së nr. 277/1997, për periudhën nga momenti i lindjes së të drejtës deri aktualisht, vijimin e pagesës së shtesës për periudhën në vijim, si dhe pagesën e kamatëvonesës ligjore deri në momentin e ekzekutimit të këtyre detyrimeve.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1035/80-2023, datë 03.05.2023, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin palëve të paditura të paguajnë solidarisht detyrimet e prapambetura të pagesës së verbërisë për palët paditëse, mes tyre edhe kërkuesi, për shkak të zbatimit gabim të indeksimit të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277/1997. Për kërkuesin është vendosur pagesa e shumës 59.921 lekë, si dhe detyrimet e prapambetura të shtesës prej 50 % të pagesës së verbërisë për shkak të humbjes së vendit të punës, për periudhën nga momenti i lindjes së të drejtës deri në ekzekutimin e vendimit në shumën totale 1.003.915 lekë.

7. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuesi (edhe paditësit e tjerë), Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe Avokatura e Shtetit. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1261, datë 04.07.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1035/80-2023, datë 03.05.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në këtë mënyrë: pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të paguajë ndaj paditësve detyrimet e prapambetura të pagesës së verbërisë sipas përcaktimeve të pikës 4 të VKM-së nr. 277/1997, si dhe rrëzimin për kërkimet e tjera. Për kërkuesin Shyqyri Tola, bazuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277/1997, ka vendosur pagesën 17.642 lekë detyrime, si dhe 10.167 lekë kamatëvonesa. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se kërkimi i parashtruar nga kërkuesi është me një vlerë që llogaritet të jetë më e vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe bazuar në nenin 56, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012) nuk lejohet të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kërkuesi në datën 01.11.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative

të Apelit, si dhe të shkronjës “ç” të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.11.2024. Në datën 20.11.2024 kërkuesi ka paraqitur shtesë të objektit të ankimit kushtetues individual, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën e dispozitivit që i përket kërkuesit, derisa të hyjë në fuqi vendimi përfundimtar i Gjykatës.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

9.1. Gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit është cenuar:

9.1.1. *E drejta për përfitime social-ekonomike, parimi i proporcionalitetit dhe barazia përpara ligjit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar në mënyrë të paarsyeshme ligjin nr. 8098/1996, si dhe VKM-në nr. 277/1997, pasi ai është invalid i pjesshëm për shkak të verbërisë, sipas vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAAP) të datës 17.02.1995, i aftë për punë që nuk kërkon mprehtësi në pamje, edhe pse e ka fituar statusin në vitin 2007. Nga mjekja e familjes në datën 31.05.2024 është lëshuar vërtetimi se pacienti vuan nga *Albinismus Et Nustagmus Congenital* (e lindur). Patologjia është congenitale e lindur dhe e pakorrigjueshme. Sipas nenit 1 të ligjit nr. 8098/1996 parashikohet se përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale. Bazuar në këtë dispozitë që të përfitosh nga statusi i të verbrit duhet të jesh i paaftë për punë në kushte normale, kriter që kërkuesi e plotësonte përmes vërtetimit të KMCAAP-së, i cili vërteton invaliditetin e pjesshëm të tij dhe paaftësinë, duke rekomanduar që ai të punojë në vende pune ku nuk kërkohet mprehtësi shikimi. Gjykata Administrative e Apelit ka keqinterpretuar faktet në raport me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 8098/1996, sipas të cilit kërkohet që përfitimi të jepet kur personi nuk ndodhet në kushte normale pune për shkak verbërie, si dhe pikën 5 të VKM-së objekt gjykimi, e cila do të duhej të interpretohej në përputhje me ligjin sipas parimit të ligjshmërisë. Kjo çështje lidhet me interpretimin e fakteve të natyrës kushtetuese, me interpretimin e ligjit dhe të pikës 5 të VKM-së, për rrjedhojë i përkiste Gjykatës së Lartë, por parashikimi sipas nenit 56 të ligjit nr. 49/2012

ndalon ushtrimin e rekursit, duke i cenuar jo vetëm të drejtën për përfitim të shtesës së pagesës së verbërisë, por edhe të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë.

9.1.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata Administrative e Apelit duke vendosur kthimin e shumës përkatëse (1.003.915 lekë) ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të krijuara nga një vendim gjyqësor. Kërkuesi ka pasur pritshmëri se nuk do të uleshin garancitë ekonomike, që i kishte dhënë gjykata administrative e shkallës së parë, duke e njohur shtesën 50 % të pagesës së verbërisë nga humbja e vendit të punës.

9.2. *Neni 56, shkronja “ç”, i ligjit nr. 49/2012* bie ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese të së drejtës substanciale me natyrë social-ekonomike të lidhura me të drejtën e ankimit në një gjykatë me të lartë, parimin e proporcionalitetit dhe të barazisë përpara ligjit. Dispozita vendos kufizim lidhur me moslejimin e rekursit në Gjykatën e Lartë për personat me aftësi të kufizuar, si kategori shoqërore me status të veçantë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individu, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Në nenin 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Gjykata ka pohuar se në këto raste kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: (i) legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individ i provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individ i provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individ ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individ i provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që

pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues do të vlerësohet legjitimitimi i kërkuarit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

11. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.1261, datë 04.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën që i përket atij, si dhe shfuqizimin e shkronjës “ç” të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, sipas së cilës: *“Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit me objekt mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.”*

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në proceset gjyqësore, objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe është bartës i së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të mbrojtura nga KEDNJ-ja dhe Kushtetuta, si për të kundërshtuar vendimin gjyqësor, po ashtu dhe për dispozitën, pasi i ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta e reale.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkojë vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliteve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues, për rrjedhojë kërkuari e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Gjithashtu, edhe për antikushtetutshmërinë e shkronjës “ç” të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, Kolegji vlerëson se kërkuari e përmbush kriterin e shterimit të mjeteve

juridike efektive, pasi i vetmi mjet në dispozicion për rivendosjen në vend të të drejtave është ankimi kushtetues individual.

15. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 04.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili i është njoftuar kërkuesit në datën 26.09.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 01.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, pasi i ka cenuar disa të drejta dhe parime kushtetuese në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme, barazisë përpara ligjit, si dhe shfuqizimin e shkronjës “ç” të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012, që parashikon se nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt kërkime me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

18. Në lidhje me pretendimin për shfuqizimin e dispozitës të sipërcituar, Kolegji thekson se në nenin 43 të Kushtetutës përcaktohet se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar. Nga përmbajtja e kësaj norme kushtetuese, Kolegji konstaton se e drejta e individit për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë nuk është çështje në diskrecion të Gjykatës, por njihet nga Kushtetuta dhe garantohet nga ligji, i cili përcakton rastet, mjetet dhe afatet ankimit. Gjithashtu, Kolegji evidenton se rregullimi kushtetues ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr.1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për më lart, Kolegji vlerëson se kërkuksi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe bindëse për të vënë në dyshim pajtueshmërinë e shkronjës “ç” të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 me Kushtetutën, për rrjedhojë pretendimi është haptazi i pabazuar.

20. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe parimit të barazisë përpara ligjit, nisur nga thelbi i argumenteve, ato, lidhen me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, për rrjedhojë Kolegji do t’i analizojë në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

21. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsytuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkuksi ka paraqitur padi në gjykatën administrative, pasi ka pretenduar se pagesa e tij për shkak të verbërisë nuk është indeksuar sipas ndryshimeve të pagës minimale, duke detyruar institucionet përkatëse për pagesën e detyrimeve të prapambetura. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur detyrimin e të paditurve për të paguar solidarisht për kërkuksin pagesën e shumës 59,921 lekë, si dhe detyrimet e prapambetura të shtesës prej 50% të pagesës së verbërisë për shkak të humbjes së vendit të punës, për periudhën nga momenti i lindjes së të drejtës deri në ekzekutimin e vendimit në shumën totale 1.003.915 lekë. Gjatë gjykimit në gjykatën administrative të shkallës së parë është caktuar edhe një ekspert kontabël për të përcaktuar detyrimet e prapambetura, duke caktuar për kërkuksin shumën e sipërcituar. Ndaj vendimit

kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 1261, datë 04.07.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1035/80-2023, datë 03.05.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur Bashkisë Tiranë të paguajë ndaj paditësve detyrimet e prapambetura të pagesës së verbërisë sipas përcaktimeve të pikës 4 të VKM-së nr. 277/1997 dhe rrëzimin për kërkimet e tjera.

24. Për kërkuesin, Gjykata Administrative e Apelit, në ndryshim nga gjykata administrative e shkallës së parë, ka vendosur ndryshimin dhe rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se nuk është provuar që kërkuesi të ketë qenë i punësuar në kohën e përfitimit të statusit si i verbër (*shih faqen 23 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur për kërkuesin pagesën e detyrimit në shumës 17 642 lekë dhe 10 167 lekë për kamatëvonesat, bazuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277/1997. Për kërkuesin, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se vlera e kërkimit është më e vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe ndaj vendimit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

25. Në vijim të sa më lart, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk rezulton të ketë ndonjë gabim të dukshëm ligjor ose faktik në lidhje me zbatimin e ligjit material dhe procedural, të tillë që ta bënte gjykimin të padrejtë, për rrjedhë pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.